



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 mars 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publike

Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve në Mocionin Përmbledhës për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve sipas Rregullës 154

Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit Nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe nenet 36(1) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”),¹ nxjerr vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 janar 2023, Trupi Gjykues urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të dorëzojë mocionin e saj sipas rregullës 154 në lidhje me grupin e dytë të dymbëdhjetë dëshmitarëve (“Mocioni sipas Rregullës 154”) deri të mërkurën, 15 mars 2023.²

2. Më 9 mars 2023, ZPS-ja dorëzoi kërkesë për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve në Mocionin e saj (“Kërkesa e ZPS-së”).³

3. Më 10 mars 2023, Trupi Gjykues njoftoi palët dhe pjesëmarrësit se: (i) nëse dëshironin t’i përgjigjeshin Kërkesës, ata duhet ta bënë këtë deri të hënë, më 13 mars 2023, në mesditë; dhe (ii) Trupi Gjykues nuk do të pranojë kundërpërgjigje.⁴ As palët, as pjesëmarrësit nuk u përgjigjën.

II. PARASHTRIME

4. ZPS-ja synon të dorëzojë një mocion përmbledhës i cili do të përmbajë të gjitha parashtrimet për të gjithë dëshmitarët përkatës dhe j kërkon shtimin e numrit të lejuar të fjalëve me 6.000 fjalë, duke bërë, në këtë mënyrë, që numri i

¹ KSC-BD-15, *Udhëzuesi i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 17 maj 2019.

² Transkripti i seancës, 18 janar 2023, f. 1902, rreshtat 14-15.

³ F01358, *Kërkesë e Prokurorisë për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve në Mocionin Përmbledhës për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve sipas Rregullës 154*, 9 mars 2023.

⁴ CRSPD185, *Përgjigje ndaj F01354-ës dhe F01358-ës*, 10 mars 2023.

fjalëve në Mocion të shkojë deri në 12.000 fjalë gjithsej.⁵ Ajo argumenton se Kërkesa e saj mbështetet në arsye të vlefshme dhe asnjë dëm nuk i shkaktohet Mbrojtjes së të Akuzuarve apo Mbrojtësit të Viktimave.⁶

5. ZPS-ja pretendon së dorëzimi i një mocioni përmbledhës: (i) i hap rrugë paraqitjes së provave përkatëse në mënyrë më efikase dhe më të përmbledhur; (ii) shmang përsëritjet e panevojshme; dhe (iii) justifikohet nga numri i dëshmitarëve dhe elementeve që duhet të trajtojë Mocioni sipas rregullës 154.⁷

III. DISKUTIM

6. Për sa i përket kohës së dorëzimit të Kërkesës së ZPS-së, Trupi Gjykses gjykon se Kërkesa është bërë në kohën e duhur duke pasur parasysh afatet e tjera me të cilat duhet të përballen palët dhe pjesëmarrësit në lidhje me fillimin e pritshëm të gjykimit më 3 prill 2023.

7. Për sa i përket kushtit për arsye të vlefshme, Trupi Gjykses merr parasysh: (i) numrin e viktimave që do të trajtohen në Mocionin sipas rregullës 154; (ii) faktin se një mocion përmbledhës për dymbëdhjetë dëshmitarët e grupit të dytë do të shmangte përsëritjet e panevojshme, duke shtuar, në këtë mënyrë, efikasitetin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i bindur që ka arsye të vlefshme për të justifikuar shtimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në 12.000 fjalë, aq sa kërkohet nga ZPS-ja.

8. Faktorët që justifikojnë Kërkesën e ZPS-së vlejné në të njëjtën mënyrë edhe për cilëndo përgjigje të dhënë ndaj Mocionit sipas rregullës 154. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses, *proprio motu*, miraton shtimin e barasvlershëm të numrit të lejuar të fjalëve, prej jo më shumë se 12.000 fjalë, për çdo përgjigje ndaj Mocionit nga cilido

⁵ Kërkesa e ZPS-së, para. 1.

⁶ Kërkesa e ZPS-së, para. 2.

⁷ Kërkesa e ZPS-së, para. 2.

ekip mbrojtjeje apo edhe pjesëmarrësit. Gjithashtu, Trupi Gjykses është i bindur se palës kundërshtare nuk do t'i shkaktohet dëm .

IV. VENDIM

9. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- (a) **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së; dhe
- (b) **SHTON** numrin e lejuar të fjalëve për Mocionin sipas rregullës 154 dhe çdo përgjigjeje ndaj tij deri në 12.000 fjalë.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith III
Kryegjykatës

E martë, 14 mars 2023

Hagë,

Holandë.